



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 513/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 03.08.2018 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

“Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “Besta” sh.p.k në procedurën e prokurimit me Nr. Ref-62585-04-14-2018, me objekt: “Asfaltim i rruges kryesore se fshatit Velmish”, me fond limit 11 802 344 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 27.04.2018, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Roskovec.

**Ankimues:**

“Deha 2010” sh.p.k  
Z.K nr. 3695, Nr.Pasurie 154/4, Fshati Vaikan, Fier

**Autoriteti Kontraktor:**

Bashkia Roskovec  
Qender, Roskovec

**Subjekt i Interesuar:**

“Besta” sh.p.k  
Ndërtesë dy katëshe, kati i dytë, Zona kadastrale 3032, Pasuria Nr.326/20, Poshnje, Berat Ura Vajgurore

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit

*publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **V ë r e n:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 16.04.2018 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit me Nr. Ref-62585-04-14-2018, me objekt: “Asfaltim i rruges kryesore se fshatit Velmish”, me fond limit 11 802 344 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 27.04.2018, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Roskovec.

II.2. Në datën 09.05.2018 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar si më poshtë:

1. “Besta” sh.p.k	7.932.500 lekë, kualifikuar
2. “Deha-2010” sh.p.k	8.206.500 lekë, kualifikuar
3. “Sark” sh.p.k	8.836.500 lekë, skualifikuar
4. “B-93” sh.p.k	10.344.700 lekë, skualifikuar
5. “Beqiri” sh.p.k	10.683.000 lekë, kualifikuar
6. “Ajzberg” sh.p.k	11.740.150 lekë, skualifikuar

II.3. Në datën 14.05.2018 operatori ekonomik “Deha 2010” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar kualifikimin e shoqërisë “Besta” sh.p.k në procedurën e prokurimit. Konkretisht pretendohet:

“[...]

1. *Operatori ekonomik “Besta” sh.p.k nuk ka paraqitur vërtetim që ka shlyer taksat vendore të Bashkisë Durrës, megjithëse ka patur seli në këtë qytet në vitin 2017.*
2. *Certifikatat ISO të paraqitura nga shoqëria “Besta” sh.p.k nuk janë të lëshuara nga një shoqëri e akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, cka i bën ato të pavlefshme. Autoriteti kontraktor mund të kontrollojë me lehtësi nëse shoqëria certifikuese që ka lëshuar certifikatat e mësipërme shoqërisë “Besta” sh.p.k në faqen <http://dpa.gov.al/sq/organizma-te-akredituara>. Shoqëria “Besta” sh.p.k nuk është certifikuar nga ndonjë oranzitatë e akredituar në Shqipëri cka i bën të gjitha certifikatat e paraqitura nga ky i fundit të pavlefshme. [...].”*
3. *Nuk ka paraqitur procesverbalin e marrjes në dorëzim të punimeve për punët e ngjashme të paraqitura nga ana e tij.*
4. *Operatori ekonomik “Besta” sh.p.k nuk ka paraqitur të gjitha dokumentat e kërkuara për mjetet e transportit vetëshkarkues dhe kamioncina pasi ka paraqitur siguracione dhe kolaudime të skaduara. Nuk ka paraqitur për mjetin Skrep fadromë lejen e qarkulimit, siguracion dhe kolaudimin e mjetit. Fadroma është mjet që regjistrohet në rregjistrat publikë sepse është mjet që qarkullon në rrugë dhe në këto kushte është detyrim ligjor pajisja e saj me leje qarkullimi.*
5. *Operatori ekonomik “Besta” sh.p.k ka paraqitur deklaratë të rreme kur në fakt të gjitha mjetet i ka të angazhuara për objektet “Ndërrhyrje emergjente për furnizimin me ujë të Urës Vajgurore nga St.Pompave Poshnje, Ura Vajgurore” dhe “Rikualifikimin urban të lagjes nr.1, Blloku 11 Janri Kucovë”. Autoriteti kontraktor ka qënë i detyruar të kërkojë informacion për mjetet që kjo shoqëri ka deklaruar si të angazhuara për 2 objektet e mësipërme. Angazhimi i mjeteve në projekte të tjera do ti sillte AK një dëm të madh, duke sjellë zvarritje dhe mospërfundim të punimeve të prokuruar prej saj.*

II.4. Në datën 30.05.2018 operatori ekonomik “Deha 2010” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar të njëjtat pretendime si edhe në autoritetin

kontraktor. Gjithashtu pretendohet se autoriteti kontraktor nuk ka kthyer përgjigje brenda afateve ligjore.

II.5. Në datën 07.06.2018 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1019/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 2450 prot., datë 07.06.2018, bashkëngjitur informacioni e dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Deha 2010” sh.p.k se: *“Operatori ekonomik “Besta” sh.p.k nuk ka paraqitur vërtetim që ka shlyer taksat vendore të Bashkisë Durrës, megjithëse ka patur seli në këtë qytet në vitin 2017”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 11 « *Kriteret e vecanta të kualifikimit* », *Kapaciteti ekonomik dhe financiar* », pikat 2.2.3, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri kualifikues si më poshtë:

*“Ofertuesi duhet të dorëzojë:  
Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore (nga Njësia Vendore ku ka seline operatori ekonomik) për vitin 2017”.*

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të shoqërisë “Besta” sh.p.k, konstatohet se për përbushjen e kriterit si më sipër cituar, kjo shoqëri ka paraqitur dokumentacionin si vijon:

1. *Ekstrakti i regjistrit tregëtar për të dhënat e subjektit “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar”, si edhe Ekstraktin Historik.*
2. *Vërtetim lëshuar nga Njësia Administrative Poshnje, Bashkia Ura Vajguore me nr. 382 prot., datë 21.04.2016 me anë të të cilës vërtetohet se subjekti “Besta” sh.p.k ka paguar detyrimet e biznesit për vitin 2016.*
3. *Vërtetim lëshuar nga Komuna Poshnje në datën 16.02.2015 me anë të të cilës vërtetohet se subjekti “Besta” sh.p.k i ka shlyer detyrimet e taksave vendore për vitin 2015.*
4. *Vërtetim lëshuar nga Komuna Poshnje në datën 19.03.2014 me anë të të cilës vërtetohet se subjekti “Besta” sh.p.k i ka paguar të gjitha detyrimet e taksave vendore për vitin 2014 ndaj Komunës Poshnje.*
5. *Vërtetim me nr. 23 prot., datë 25.01.2017, lëshuar nga Bashkia Durrës, sipas së cilës vërtetohet se subjekti “Besta” sh.p.k nuk ka detyrime deri në datën e marrjes së vërtetimit*

(deri në 31.12.2016).

6. Vërtetim lëshuar nga Bashkia Ura Vajgurore, Njësia Administrative Poshnje me nr. 426 prot., datë 26.04.2017 sipas të cilës shoqëria “Besta” sh.p.k ka shlyer të gjitha detyrimet e taksave vendore dhe të biznesit për vitin 2017.
7. Vërtetim me nr. 123 prot., datë 28.04.2017, lëshuar nga Bashkia Durrës, sipas së cilës vërtetohet se subjekti “Besta” sh.p.k nuk ka detyrime deri në datën e marrjes së vërtetimit.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.1.4. Neni 5 “Rregulla të përbashkëta për taksat vendore” i Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar parashikon se:

*Me përjashtim të rasteve kur në këtë ligj përcaktohet shprehimisht ndryshe, këshilli i bashkisë:*

- a) bën edhe kategorizime më të hollësishme, në përputhje me kushtet dhe interesat vendorë, brenda kategorive minimale të bazës së taksës, të përcaktuar në këtë ligj;
- b) vendos për nivelin e taksës, brenda kufijve të përcaktuar në këtë ligj, për çdo kategori e nënkategori të bazës së taksës;
- c) përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale;

Neni 9 i Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar parashikon se:

*Në taksat vendore përfshihen:*

1. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.
2. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat, taksa mbi tokën bujqësore dhe taksa mbi truallin.
3. Taksa e fjetjes në hotel.
4. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja.
5. Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.
6. Shfuqizohet.
7. Shfuqizohet.
8. Taksa e tabelës.
9. Taksa të përkohshme.

Në nenin 11, pika 2 të të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, parashikohet se: “[...]Detyrimi i taksës për t’u paguar nga çdo biznes, në çdo

*vendndodhje biznesi, përcaktohet në përputhje me kategorinë e biznesit, që kryhet në kohën e regjistrimit dhe reregjistrimit të tij[...]*”.

Neni 12 “*Rregjistrimi dhe Liçensimi*” i Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “*Për sistemin e taksave vendore*” i ndryshuar parashikon se: *Taksapaguesit, subjekte të këtij ligji, regjistrohen, për qëllime fiskale, pranë Qendrës Kombëtare të regjistrimit, në përputhje me ligjin e posaçëm. Ndryshimet në vendin e ushtrimit të veprimtarisë dhe të të dhënave të tjera tregtare kryhen sipas dispozitave të ligjit për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.*

III.1.5. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.6. Referuar sa më sipër komisioni konstaton se në kriterin e vecantë të kualifikimit autoriteti kontraktor ka kërkuar nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dorëzojnë *vërtetim per shlyerjen e taksave vendore (nga Njesia Vendore ku ka seline operatori ekonomik) per vitin 2017.*

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Deha 2010” sh.p.k për mospagimin e taksave vendore nga ana e operatorit ekonomik “Besta” sh.p.k për Bashkinë Durrës, nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ky i fundit në përmbushje të këtij kriteri, rezulton se është dorëzuar dokumenti me nr. 123 prot., datë 28.04.2017, lëshuar nga Bashkia Durrës, sipas së cilës vërtetohet se subjekti “Besta” sh.p.k nuk ka detyrime deri në datën e marrjes së vërtetimit, pra deri në datën 28.04.2018.

Komisioni verifikoi të gjitha ndryshimet në të dhënat e regjistruara të pasqyruara në mënyrë kronologjike në Ekstraktin Historik të subjektit “Besta” sh.p.k. Nga ky verifikim rezulton se shoqëria “Besta” sh.p.k ka shtuar adresën e aktivitetit në Durrës në datën 06.12.2016, të cilën e ka hequr në datën 23.06.2017, ndërsa në datën 28.04.2017 është pajisur me vërtetim nga Bashkia Durrës për likuidimin e detyrimeve deri në datën e marrjes së vërtetimit. Sipas Ekstraktit Historik të QKB-së rezulton se kjo shoqëri ka ushtruar aktivitet në Durrës deri në datën 23.06.2017.

Në këto kushte, vërtetimi i paraqitur nga Bashkia Durrës për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2017, nuk e përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi operatori ekonomik “Besta” sh.p.k ka ushtruar aktivitet në Bashkinë e Durrësit deri në datën 23.06.2017, ndërkohë që vërtetimi i paraqitur është lëshuar përpara datës së mbylljes së aktivitetit dhe vërteton shlyerjen e detyrimeve deri në atë datë.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në

përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. Në këto kushtë, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Besta” sh.p.k, në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se: *“Certifikatat ISO të paraqitura nga shoqëria “Besta” sh.p.k nuk janë të lëshuara nga një shoqëri e akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, cka i bën ato të pavlefshme. Autoriteti kontraktor mund ti kontrollojë me lehtësi nëse shoqëria certifikuese që ka lëshuar certifikatat e mësipërme shoqërisë “Besta” sh.p.k në faqen <http://dpa.gov.al/sq/organizma-te-akredituara>. Shoqëria “Besta” sh.p.k nuk është certifikuar nga ndonjë oranzatë e akredituar në Shqipëri cka i bën të gjitha certifikatat e paraqitura nga ky i fundit të pavlefshme. [...].”*

III.2. 1. Në shtojcën shtojcën 11 « *Kriteret e vecanta të kualifikimit* », “*Kapaciteti teknik* », pika 2.3.7, rezulton se nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri:

*“2.3.7.Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se e zhvillon aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi, në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë, mjedisit*

*Për këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikatat e mëposhtme:*

*ISO 9001:2015,*

*ISO 14001 – 2015,*

*ISO 39001:2012,*

*ISO, PAS 99-2012,*

*OHAC 18001:2007.”*

III.2.2. Për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “Besta” sh.p.k ka paraqitur dokumentacionin si vijon:

1. Certifikatë ISO 9001:2015 “*Për sistemin e menaxhimit të cilësisë*”, lëshuar nga kompania AQSCERT në emër të shoqërisë “Besta” sh.p.k, në fushat e mëposhme: *“Ndërtim dhe rikonstruksion i ndërtesave civile-industriale , ujësjellësave, kanalizimeve, veprave të kullimit dhe ujitjeve, mbrojtje lumore dhe sisteme hidraulike. Ndërtim, rikonstruksion dhe mirëmbajtje të infrastrukturës rrugore. Zbatime të punimeve për sisteme të hapësirave të gjelbërta dhe mbjellje bimësh e pemësh. Tregtim pjesë këmbimi, servis për mjetet dhe makineritë”*.
2. Certifikatë ISO 14001:2015 “*Për sistemin e menaxhimit të mjedisit*”, lëshuar nga kompania AQSCERT në emër të shoqërisë “Besta” sh.p.k, në fushat e mëposhme: *“Ndërtim dhe rikonstruksion i ndërtesave civile-industriale, ujësjellësave, kanalizimeve, veprave të*

*kullimit dhe ujitjeve, mbrojtje lumore dhe sisteme hidraulike. Ndërtim, rikonstruksion dhe mirëmbajtje të infrastrukturës rrugore. Zbatime të punimeve për sisteme të hapësirave të gjelbërta dhe mbjellje bimësh e pemësh. Tregtim pjesë këmbimi, servis për mjetet dhe makineritë”.*

3. Certifikatë BS OHSAS 18001:2015 “*Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë*”, lëshuar nga kompania AQSCERT në emër të shoqërisë “Besta” sh.p.k, në fushat e mëposhme: “*Ndërtim dhe rikonstruksion i ndërtesave civile-industriale, ujësjellësave, kanalizimeve, veprave të kullimit dhe ujitjeve, mbrojtje lumore dhe sisteme hidraulike. Ndërtim, rikonstruksion dhe mirëmbajtje të infrastrukturës rrugore. Zbatime të punimeve për sisteme të hapësirave të gjelbërta dhe mbjellje bimësh e pemësh. Tregtim pjesë këmbimi, servis për mjetet dhe makineritë*”.
4. Certifikatë BS PAS 99:2012 “*Për sistemin e menaxhimit të integruar*”, lëshuar nga kompania AQSCERT në emër të shoqërisë “Besta” sh.p.k, në fushat e mëposhme: “*Ndërtim dhe rikonstruksion i ndërtesave civile-industriale, ujësjellësave, kanalizimeve, veprave të kullimit dhe ujitjeve, mbrojtje lumore dhe sisteme hidraulike. Ndërtim, rikonstruksion dhe mirëmbajtje të infrastrukturës rrugore. Zbatime të punimeve për sisteme të hapësirave të gjelbërta dhe mbjellje bimësh e pemësh. Tregtim pjesë këmbimi, servis për mjetet dhe makineritë*”.
5. Certifikatë ISO 39001:2012 “*Sistemi i menaxhimit të sigurisë së trafikut rrugor*”, lëshuar nga kompania KING CERT për shoqërinë “Besta” sh.p.k, në fushat e mëposhme: “*Ndërtim dhe rikonstruksion i ndërtesave civile-industriale, ujësjellësave, kanalizimeve, veprave të kullimit dhe ujitjeve, mbrojtje lumore dhe sisteme hidraulike. Ndërtim, rikonstruksion dhe mirëmbajtje të infrastrukturës rrugore. Zbatime të punimeve për sisteme të hapësirave të gjelbërta dhe mbjellje bimësh e pemësh.*”

III.2.3. Në nenin 46 “*Kualifikimi i ofertuesve*”, pika 1 dhe 2 e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, parashikohet se “*[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:*

*Autoriteti kontraktor mund të kërkojë edhe certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit. [...]*”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: “*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...*”

III.2.4. Në nenin 30 “*Kërkesat e cilësisë*” të VKM Nr.914 datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar parashikohet se:



1. *Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.  
Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.*
2. *Çertifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit”.*

III.2.5. Pas një verifikimi të kryer në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit <http://dpa.gov.al/sq/organizma-te-akredituara>, lidhur me organizmat e akredituara nga DPA, rezulton se kompania AQScert, me kod CS007 dhe fushë adreditimi: “Organizëm që operon në certifikimin e sistemeve të menaxhimit sipas SSH ISO/IEC 17021-1:2015”, nuk është e akredituar për standardin BS PAS 99:2012.

III.2.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kapaciteteve të kërkuara në dokumentat e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor, do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit në respekt të nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi. KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Bazuar në sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se Certifikata BS PAS 99:2012 “Për sistemin e menaxhimit të integruar”, lëshuar nga kompania AQSCERT në emër të shoqërisë

“Besta” sh.p.k, nuk është e vlefshme pasi vetë kompania AQSCERT nuk është e akredituar për këtë lloj standardi.

Për më tepër, nga verifikimet e kryera në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit rezulton se kompania KING CERT e cila ka certifikuar shoqërinë “Besta” sh.p.k për sistemin e menaxhimit ISO 39001:2012 “Sistemi i menaxhimit të sigurisë së trafikut rrugor”, në fushat: “Ndërtim dhe rikonstruksion i ndërtesave civile-industriale , ujësjellësave, kanalizimeve, veprave të kullimit dhe ujitjeve, mbrojtje lumore dhe sisteme hidraulike. Ndërtim, rikonstruksion dhe mirëmbajtje të infrastrukturës rrugore. Zbatime të punimeve për sisteme të hapësirave të gjelbërta dhe mbjellje bimësh e pemësh”, nuk figurojnë në listën e organizmave të akredituara nga DPA. Gjithashtu nga verifikimet në kryera në faqen zyrtare on-line të kompanisë KING CERT, nuk rezulton të jetë e akredituar për sistemin e menaxhimit ISO 39001:2012.

Në këto kushte, Komisioni gjykon se, operatori ekonomik “Besta” sh.p.k. nuk e përmbush kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në shtojcën nr. 11, pika 2.3.7 “Kapaciteti teknik” në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, pasi me anë të dokumentacionit të dorëzuar, operatori ekonomik “Besta” sh.p.k nuk garanton autoritetin kontraktor për përmbushjen e kriterit lidhur me certifikatat ISO , sipas kërkesave të autoritetit kontraktor dhe për këtë arsye duhet skualifikuar.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik ankimes “Deha 2010” shpk për skualifikimin e ofertës së shoqërisë “Besta” sh.p.k në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimet e trajtuara më sipër qëndrojnë dhe gjendja faktike juridike e shoqërisë “Besta” sh.p.k pas arsyetimit të K.P.P. do të ndryshojë duke u skualifikuar, shqyrtimi në temel i pretendimeve të tjera të ankimesit në fjalë nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 23 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

### **Vendos**

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Deha 2010” sh.p.k për procedurën e prokurimit me Nr. Ref-62585-04-14-2018, me objekt: “Asfaltim i rruges kryesore se fshatit Velmish”, me fond limit 11 802 344 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 27.04.2018, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Roskovec.

2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomik “Besta” sh.p.k, dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si mësipër, duke e skualifikuar këtë ofertues.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Deha 2010” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**Nr. 1019 Protokolli,**

**Datë 30.05.2018**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**



**Kryetar**  
**Evis Shurdha**